РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ДКСК ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KSHPK KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Врз основа на член 22 став 1 од Законот за спречување на корупцијата и судирот на интереси („Службен весник на Република Македонија" број 12/2019), член 40 став 3 од Деловникот за работа на Државната комисија за спречување на корупцијата, Државната комисија за спречување на корупцијата (во натамошниот текст: ДКСК), постапувајќи по предмет оформен по сопствена иницијатива, на 82-та седница одржана на ден 14.02.2023 година донесе

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 82-të, të mbajtur më datë 14.02.2023 morri,

## VENDIM

Procedura e KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-4839/1 datë 12.11.2021, e krijuar me vetiniciativë , për shkeljen e dispozitave të nenit 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nga ___________________________, ish anëtar i _____________________,NDËRPRITET.

Konstatohet se pas kundërvajtjes së lëshuar me urdhërpagesë me numër 08-5980/2 të datës 16.06.2022, është vepruar nga ana e të emëruarit, përkatësisht në të është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## О б р а з л о ж е н и е

Lënd e regjistruar me numër 08-4839/1 të datës 12.11.2021 është formuar me vetiniciativë për shkelje të dispozitave të nenit 82 e formuar me vetiniciativë.

KSHPK, nga kontrolli në Gazetën zyrtare të RMV-së me numër 190/2021 përcaktoi se ____________________________ me Vendim nr. 14 – 8457/1 të datës 30.07.2021 është shkarkuar nga detyra ish anëtar në ______________________________ dhe në afatin e paraparë me ligj pas mbarimit të funksionit nuk dorëzoi fletë anketuese në KSHPK.

Për sa më sipër, KSHPK-ja personit të emëruar i lëshoi urdhërpagesë kundërvajtëse me nr. 08 – 5979/2 të datës 16.06.2022, për shkelje të kryer nga neni 82 paragrafi 3 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, i dënueshëm sipas nenit 109 të të njëjtit ligj.

Nga ana e personit të përmendur më lart, në afatin e paraparë ligjor është vepruar sipas urdhër pagesës kundërvajtëse të lëshuar ndaj tij, gjegjësisht është paguar gjysma e gjobës ndaj të njëjtës.

Në bazë të sa më sipër, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti:A.Ç.
Miratoi: Mr. Vladimir Georgiev anëtar në KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORË**
**PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
**NËNKRYETARE,**
**Katica Nikolovska**

Адреса: ул. Пресвета Богородица бр.3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk